

ALBANIAN POST

**Nr.
15**

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - mail@albanianpost.co.uk - www.albanianpost.co.uk - www.fjalaelire.com



04 Shitet restoranti...



06 Kur bluzat e bardha...



17 Peticion...

**NËNTOR /
NOVEMBER
2019**

Më 28 nëntor 1443 i madhi Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ngrii flamurin kombëtar në kalanë e Krujës. Më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali ngrii flamurin në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Më 28 Nëntor, të gjithë shqiptarët, në trojet e tyre dhe kudo jetojnë e punojnë nëpër botë, kremtojnë me krenari dhe emocion, Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga perandoria otomane turke. Më 28 nëntor 1443 i madhi Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të cilin sivejet i kremtohet jubileu i 550-vjetorit të vdekjes, ngrii flamurin kombëtar në kalanë e Krujës. Ndërkaq, më 28 nëntor të vitit 1912, Ismail Qemali ngrii flamurin kombëtar në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Kjo ditë shënon pavarësinë e kombit shqiptar...

(vijon ne faqen 02)

28 NËNTORI FESTË E TË GJITHË SHQIPTARËVE: GËZUAR!



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



24/7 orë linjë emergjence

07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Main Office

190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM

211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station



(vjon nga faqja 01) ...Pavarësia e Shqipërisë nga perandoria turke, mjerisht jo e të gjitha trevave shqiptare, pra, u përgatit me vite e vite kryengritjesh, që filluan në viset e ndryshme Arbënore nga Malësia e Mbishkodrës, Mirdita dhe vende e vise tjera, për të përfshirë më vonë krejt Shqipërinë e atëhershme. U desh fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe shkatërrimi i perandorisë së xhonturqve, që shqiptarët të kurorëzonin ëndrrën e viteve për një Shqipëri “më vehte, të lirë e të mosvarme”. Kështu, si sot, më 28 nëntor të vitit 1912, në Vlorë, u ngrit Flamuri dhe u hap Kuvendi historik Kombëtar me 37 delegatë, por u deshën vite të tjera dhe përfaqësi në Kongrese e në kancelaritë e vendeve perëndimore, që Shqipëria të njihej si e

tillë nga fuqitë e Shtetet e kohës. Prandaj, më 28 nëntor shqiptarët kujtojnë ngjarjen e 1912-tës që ndodhi në Vlorë, ku u ngrit Flamuri Kombëtar i Kastriotëve, simbol i lirisë, i pavarësisë, i ëndrrave për një ardhmëri më të mirë të kombit shqiptar në gjirin e kombeve të përparuara të botës. Pra, Dita e shpalljes së Pavarësisë, që përkujtohet çdo 28 Nëntor, na nxit të meditojmë për fatet historike të Kombit shqiptar, me të cilat lidhen në mënyrë të pazgjidhshme edhe fatet e çdo shqiptari e për vlerat që përmban e rrezaton Flamuri Shqiptar. Kujtimi që sot na çon sa në 28 Nëntorin e 1912-tës, na sjell në mendje e në zemër edhe rrugën e përshkuar gjatë vjetëve e shelujve nga ata shqiptarë, që pa asnjë dallim e me përkushtim, bindje punuan



dhe flijuar gjithçka, madje edhe jetën për Atë Ditë e për vlerat e patjetërsueshme që simbolizon Flamuri Kuq e Zi. Një kontribut domethënës që çoi deri në shpalljen e pavarësisë së shqiptarëve nga pushtuesi otoman, dhanë edhe katolikët shqiptarë. “Uroj që shqiponja të cilën e shikojmë në flamurin

e vendit tuaj, t’ju kujtojë gjithnjë shpresën për ta mbështetur përherë besimin tuaj në Hyjin, që nuk zhgënjën, por është gjithnjë përkrah nesh, posaçërisht në çaste të vështira. Shqiponja nuk e harron follenë po fluturon gjithnjë lart”. (Papa Françesku, Tirane 21 shtator 2014)

 **JETONI**
TRANSPORT MALLRASH
ANGLI - SHQIPERI - ANGLI



Ne transportojmë valixhet tuaja të bagazheve dhe çantat e dorës duke ua dorëzuar të afërmve tuaj me përgjegjësi të plotë.

info@jetonitransport.co.uk

+44 7 737 597 000

+44 7 507 444 654

jetonitransport.co.uk

+355 68 22 0 5555



 **JETONI**
TRANSPORT MALLRASH
ANGLI - SHQIPERI - ANGLI

185 Station Road, Edgware, HA8 7JX

0209306873

MIRËSEVINI

CRYSTAL
CAFE

MUZIKË LIVE E PREMTE DHE SHTUNË



Ne Ofrojmë:

Ushqime tradicionale, Evenimente festive, ditëlindje, mbrëmje, dasma etj. (50-60 vetë)
Pije të ndryshme shqiptare:
Verë të kuqe dhe të bardhë
Raki Rushi Skrapari

FORUMI I BASHKIMIT TE SHOQATAVE SHQIPTARE JU FTON:

**23 NENTOR 2019
ORA 16:00**

FESTIME MADHËSHTORE

**Ejani të festojmë së bashku
28 Nëntorin, Festën Kombëtare
të Pavarësisë së Shqipërisë!**

**Të ftuar parlamentarë britanikë, zyrtarë vendas,
intelektualë e të tjerë miq dhe mike të Kombit tone.**

**Adresa:
Haverstock School
24 Haverstock Hill, Chalk Farm,
London NW3 2BQ**

**Parkimi: Falas; Hyrja: Falas
Stacioni më i afërt: Chalk Farm**

Gëzuar Ditën e Pavarësisë Kombëtare!

RESTAURANT PEA SHITJE

Kapaciteti: 350 vende
Parkingu: 2 minuta larg
Licence Alkooli
Kuzhina moderne
Piceri

Salla per dasma, ditelindje, festa, okazione
festive dhe rinore

Gjendet ne rrugen kryesore ne zemer
te Watford

Vendi mjaft i pershtashem
Per me shume informacion:
email: sokol_toska@hotmail.com
Mob: 07801950726





RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Specializuar në emigracionin e Britanisë së Madhe

Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet
përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

Çdo klient është po aq unik sa është rasti që ata na sjellin

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e
tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani
e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i
Rregullimit të Aplikantëve.

Një minutë larg nga South Wimbledon Underground Station

Për të biseduar në shqip telefono Gena:

07774222062

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent për t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit

- zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim juridik
- Apelim Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

Main Office

190 Merton high street,
Wimbledon, London,
SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666
Gena: 07774222062

RASHID & RASHID LAW FIRM

211, The Broadway, Southall,
UB1 1NB
law768@live.com
Tel: 02086720666
Fax: 02085430534

KUR BLUZA E BARDHË FLET JO THJESHT PËR HUMANIZËM

Me profesionalistin e kahershëm të shëndetësisë shqiptare, Demush Cufaj, biseda e kapërcen kohën e planifikuar për një kafe në mjediset e Sweet London në Barking të Londrës. Në shoqërinë e të birit, biznesmenit të suksesshëm, Gazmend Cufaj, dhe nën shoqërinë dhe respektin kalimtar të pronarit të këtij lokali të këndshëm, Rraman Gjana, por dhe të disa dhjetëra miqve e të njohurve të fisit Cufaj, ajo që sillet në kohë, hapësirë dhe vend është dashuria për njëritjetrin, miqësia dhe kultura e komunikimit. “Ndjehesh vërtetë që je Shqiptar në këtë qasje të bukur dhe tejet domethënëse!”

Kështu i biri i Beqir Cufaj, “Qytetari të Nderit” të Kamzës, që ndoqi udhën e mjekësisë së projektuar prej tij që në ditët e para të çlirimit të Atdheut, ka shumë arsye të rrëfejë për dhimbjet dhe problematikën që ai dhe familja e tij kishin në kohën e diktaturës komuniste. Dhe kjo pasi vëllai i Beqirit do të kalonte kufirin dhe ku

pastaj drama dhe komedia do të shkonte herë në dhimbje e herë në tragjedi komike. Teksa kujton si nëpër vrimë të gjilpërës, jetën, udhën dhe mundin e tij për të rritur fëmijë të kulturuar dhe me shkollë të lartë, naturisht ai sjell dhe të bijën që e ndjek në zanatin e bluzëbardhëve. Dhe kështu Demushi u thërret në qetësi kujtimeve të tij, sado të dhimbshme që kanë qenë ato hera-herës. Natyrshëm shkon më tej në rrëfim e bisedë..., edhe me ata që tashmë i sillen rrotull në udhët e jetës me buzëqeshje ironike. Dhe ashtu u thotë kujtimeve se “Fatkeqësisht nuk jeni për të gjithë!”

Fatkeqësisht nuk jeni për të gjithë, por dhe pse zërtheheni, ju flisni për kohërat e kohërave të turbullta. Jo të gjithë do t’ju pëlqejnë. Jo të gjithë do të ju duan pavarësisht nga ajo që bëni dhe sa bukur rrëfehëni për një person, apo dhe për të Tjerët, edhe ashtu sikurse keni qenë në kujtimet tona me lotë, por edhe kushtu siç ndodh të rrëfehëni e



të jeni në memorjet tona.

E kjo ndodh edhe për Njeriun e sotëm, edhe për brezat... kur dihet se jo të gjithë do të vuajnë me energjinë tuaj dhe jo të gjithë do t’u kuptojnë dhe ju mbështesin. Edhe pse kjo sikurse në të gjitha kohërat, është një pilulë e hidhur për të gëlltitur ndonjëherë mos lejoni që ajo të bëjë një trazirë të emocionit tuaj dhe të shkatërrojë energjinë tuaj. Sepse koha dhe energjia juaj është shumë më e çmuar sesa ta shterroni veten duke e bërë

formën e duhur për t’u përkëdhelur tekat e të tjerëve, duke e formuar veten për tu përshtatur në çdo vend ku dhe kështu duke mos mbajtur asnjë formë për ta thirrur në kohn dhe momentin e duhur, tuajin respekt dhe privilegj të Njeriut. Dhe ai qшту qetë këshillon me mirësi për të gjithë...

Zgjidhni të mos sakrifikoni veçantinë tuaj për të dorëzuar koren e bukës së jetës. Të jesh selektiv me energjinë tënde duke i lënë lamtumirën atyre

që të pengojnë ecurinë e vlerave dhe stilit të jetës tuaj që më së shumti rezonojnë me ju. Zgjidhni të mos merrni rreziqe sociale, pavarësisht nga shikimet e pakëndshme dhe pëshpëritjet fodullëqe. Zgjidhni të mos kujdeseni për atë që mendojnë të tjerët deri në atë pikë sa e ngulmon aftësinë tuaj për të marrë rreziqe dhe për të prishur kënaqësinë tuaj sociale.

Sepse nuk ka asgjë më çliruese sesa të mos humbësh jvlerën tënde duke i lejuar fajet që të gjykojnë veprimet e tua. Për të kërkuar të përafroni veprimet tuaja me zemrën tuaj. Të qëndrosh në këmbë për diçka, të bësh dhe të besosh atë që sjell përmbajtje pavarësisht se nuk i pëlqen dikujt është mirësi, është humanizëm. Është shumë e dashur që të qenit vetja juaj autentike është në shërbim të jetës, Tjetrit dhe Njeriut.

Ky është Njeriu i cili mbajti Bluzën e Bardhë, jo thjesht për të jetuar, por për të trashëguar traditën e respektin, udhën e jetës së rekomanduar nga baba i tij, Beqir Cufaj.





THE BALKAN

BAR & RESTAURANT

66c Ealing Road,
Wembley,
HA0 4TH

Salla moderne për dasma dhe
okazione të tjera festive,
familjare dhe shoqërore.

Kapaciteti i sallës kryesore:
150 vetë.

Kapaciteti i sallës pritëse:
80 vetë.

Shërbim profesional. I
kulturuar. Modern. Çmime
konkuruese.

5 minuta nga Undergroundi
Wembley Central

07429459851

SKELA "JET SCAFFOLDING" CILËSI, PROFESIONALIZËM, GARANCI

Skela "Jet Scaffolding" tregon gjithnjë e më shumë përkujdesje në të tre elementët e saj të suksesit. Themelet e mira janë thelbësore. Shpesh kornizat e skelave kërkojnë më shumë pllaka bazë të thjeshta për të kryer dhe përhapur në mënyrë të sigurt ngarkesën. Skela "Jet Scaffolding" përdor pllaka bazë në sipërfaqe të betonit. Për sipërfaqet si trotualet ose pllakat bazë të asfaltit janë të nevojshme. Për sipërfaqet më të buta ose më të dyshimta përdor tabela të vetme, nën një standard të vetëm, një tabelë e vetme duhet të jetë së paku 1.000 centimetra katrorë (160 in²) pa një dimension më të vogël se 220 milimetra, trashësia duhet të jetë së paku 35 milimetra (1.4 in). Për skelat e ngarkesës më të rënda mund të kërkohej shumë më tepër elementë të betonit të vendosura në beton. Në hapat e pabarabartë të terrenit që priten për pllakat bazë, rekomandohet një madhësi minimale e hapit prej rreth 450 milimetra (18 in). Një platformë pune kërkon që elementë të tjerë të jenë të sigurt. Ata duhet të jenë të ngushtë, të kenë binarët me mburojë

të dyfishtë dhe të gishtin dhe të ndalojnë dërrasat. Duhet gjithashtu të sigurohet qasje e sigurt dhe e sigurt.

Komponentët themelorë të skela "Jet Scaffolding" janë tubat, bashkuesit dhe dërrasat. Tuba zakonisht bëhen prej çeliku ose alumini; megjithëse ka skela të përbërë që përdor tuba të fibrave të qelqit të mbështjella me filamente në një matricë najloni ose poliestër, për shkak të kostos së lartë të tubit të përbërë, zakonisht përdoret vetëm kur ekziston rreziku nga kabllo elektrike që nuk mund të izolojnë. Nëse janë çeliku, ato janë ose "të zeza" ose galvanizuar. Tubat vijnë në një sërë gjërash dhe një diametër standard prej 48.3 mm. (1.5 tubacione NPS). Dallimi kryesor midis dy llojeve të tubave metalik është pesha më e ulët e tubave të aluminit (1.7 kg / m në krahasim me 4.4 kg / m). Megjithatë ato janë më fleksibile dhe kanë një rezistencë më të ulët ndaj stresit. Tuba zakonisht blihen në gjatësi 6.3 m dhe pastaj mund të priten në madhësi të caktuara tipike. Shumica e kompanive të

mëdha do t'i shesin tubat e tyre me emrin dhe adresën e tyre për të penguar vjedhjen. Bordet ofrojnë një sipërfaqe pune për përdoruesit e tribunave. Ata janë dru të kalitur dhe vijnë në tre trashësi (38 mm (e zakonshme), 50 mm dhe 63 mm) janë një gjerësi standarde (225 mm) dhe janë një gjatësi maksimale prej 3.9 m. Mbërritjet e tabelës mbrohen me pllaka metalike të quajtura pranga ose ndonjëherë pllaka gozhdë, të cilat shpesh e kanë vulosur emrin e kompanisë në to. Dyllat e tribunave të drurit në Britani të Madhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 2482. Po ashtu, përdoret edhe stolisje druri, çeliku ose alumini, si dhe pllaka të laminuara. Përveç tabelave për platformën e punës, ekzistojnë bordet e vetme të cilat vendosen nën skelë nëse sipërfaqja është e butë ose që dyshohet ndryshe, megjithëse mund të përdoren edhe bordet e zakonshme. Një tjetër zgjidhje, e quajtur skatepad, është bërë nga një bazë gome me një pllakë bazë të formuar brenda; këto janë të dëshirueshme për përdorim në tokë të pabarabartë pasi

ato përshtaten, ndërsa bordet e vetme mund të ndahen dhe duhet të zëvendësohen. Skela, e quajtur edhe skelet, është një strukturë e përkohshme e përdorur për të mbështetur ekuipazhin e punës dhe materialet për të ndihmuar në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave, urave dhe të gjitha strukturave të tjera të bëra nga njeriu. Skelat janë përdorur gjerësisht në vend për të pasur akses në lartësitë dhe zonat që përndryshe do të ishin të vështira për t'u arritur.



ORDER NOW
and get 4 to 6 weeks
Free Hire
Call: 019 2351 8933



JET
SCAFFOLDING
LTD

Jet Scaffolding
Unit 212 Flexspace
5 Elstree Way Borehamwood
London
WD6 1SF

Tel: 0192 351 8933
Mob: 077 3874 0018
E-mail: info@jetscaffolding.com

**"Skela Jet" është e bazuar
në Watford, Hertfordshire dhe mbulon
të gjitha zonat në Londër.**

ERMAL KARAKUSHI, INXHINIERI ELEKTRIK, NJERIU HUMAN DHE INXHINIERI ELEKTRIK I RESPEKTUAR

Në fakt ishte një bisedë mjaft e thjeshtë, një komunikim njerëzor, një qasje e urtë e “muhabetit”, pikërisht në hapjen e një shkolle shqipe të arsimit plotësues në Walthamstow ajo që na bëri të ulemi “këmbëkryq” me një shqiptar të mirë, një profesionist në fushën e tij, një intelektual, që menjëherë të bën për vete. Fjalëmaturo, fjalëpak dhe mjaft i ndjeshëm ndaj dhimbjes së Tjetrit. Ndërsa sheh një jetim, një fëmijë që i ati i ka ndërruar jetë nga Zoti në kohë tjetër, menjëherë i afrohet fëmijës së vet, që ka ardhur të jetë nxënës i shkollës shqipe dhe i lutet ti japë një ndihmë të vogël të cilën e bën krejt në mënyrë të fshehtë, pa u dukur dhe mjaft njerëzisht. Në Walthamstow që është qyteti kryesor i London Borough të Waltham Forest në East London, të Anglisë në atë ditë ishin edhe dhjetëra

prindër shqiptarë, dhe gjithë stafi i Ambasadës shqiptare, me Ambasadorin e Shqipërisë Qirjako Qirko. Bashkia që është e vendosur 7.5 milje (12.1 km) në verilindje nga Charing Cross, kishte mjaft shushërima fëmijësh të gëzuar në atë ditë, dhe po aq thujase se fliste shqip në atë kënd ku fëmijët ishin në ditën e hapjes festive të shkollës. Historikisht kjo minibashki që bën pjesë në qarkun e Essex, është rritur në mënyrë të konsiderueshme si pasojë e shtimit të popullsisë, si pjesë e rritjes periferike të Londrës dhe është themeluar si një njësi bashkiake në vitin 1929 para se të bëhej pjesë e Greater London në vitin 1965. Tashmë ajo ka natyrisht dhe shqiptarët e shumtë në atë zonë. Walthamstow është një qytet i madh, i vendosur në mes të Veriut dhe deri në Lee Valley dhe rezervuarin Walthamstow në perëndim,

si dhe Epping Forest në lindje. Qendra e qytetit përbëhet nga pjesa e Tregut Walthamstow, tregu më i gjatë vetëm në rrugë në Evropë. Dhe mes kësaj gjallërie biseda me këtë njeri na bëri të harrojmë kohën. Na bëri të shkojmë gjatë e gjerë në kujtesa e memorje, na bëri të rikujtojmë dhimbje e gjëra të shkuara, që hera-herës therrin dhimbjet njerëzore. Por mbi të gjitha na njohu me një njeri. Na njohu me një specialist mjaft të kërkuar. Për këtë mjafton të klikosh në google dhe në fushën e inxhinierit elektrik në Britani të madhe dhe natyrisht të shënosh emrin Ermal Karakushi. Ermal Karakushi është një nga inxhinierët elektrikë më të kërkuar, më të zotë në zonën e South West e më gjerë. Ai ka vite dhe plot njëzetë të tilla që ushtron këtë profesion me mjeshtëri. Të paktën kështu thuhet në disa media britanike online.

Tashmë sa lexon në rrjetet profesionale, mëson se kur ju dëgjoni emrin Ermal Karakushi, inxhinieri Elektrik, krijoni një familjaritet që kumbon në mendjen tuaj. Ky familjaritet rrjedh natyrisht, nga profesionalizmi i tij, eksperiencia që ai ka shërbyer të gjithëve klientëve për mbi 20 vjet. Ermal Karakushi ka vendosur veten si udhëheqës si një nga mjeshttrat e shërbimeve elektrike, të shërbimit profesioanl e të sigurtë dhe ka marrë përsipër detyrën e tu afroje klientëve të tij më të aftën, të certifikuarën dhe shërbim të besueshëm elektrik, dhe të kujdeset për të gjitha nevojat elektrike. Ermal Karakushi është për të gjithë, nëse jeni një pronar me shtëpi, ndërtues, menaxher i pronës, ose pronari i biznesit, ju mjafton të telefononi mjeshttrin Karakushi dhe do të na besoni për vlerësimin tuaj të mirë.

ERMAL KARAKUSHI

PËRSE DUHET TË NA ZGJIDHNI NE

- ✓ INSTALIM I PLOTË OSE I PJESSHËM
- ✓ ZËVENDËSIME TË SISTEMIT TË SIGURASAVET
- ✓ SHITESË PRIZASH/ ÇELESAT, NDRIÇIMI ETJ.
- ✓ DUSHE/ LIDHJE GATIMI
- ✓ SISTEMET E NGROHJES/ STORAGE
- ✓ SHËRBBIME PROFESIONALE ELEKTRIKE

ermal_niceic@hotmail.co.uk

Zyra: 020 8443 3833

Tel: 07568393784

TË GJITHA NGA
NDERRIMI I
LLAMPAVE. NDRIÇIMI
DERI TEK SKEMAT
PROFESIONALE DHE
INSTALIMI

INXHINIER ELEKTRIK

HISTORIKE: ÇFARË DISKUTUAN NË TAKIM ALBIN KURTI DHE SALI BERISHA?



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka zhvilluar një takim historik me ish-kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha. Edhe pse Kurti dhe Berisha kanë qëndrime dhe ide të ndryshme politike, ajo që i ka bashkuar është pikërisht çështja kombëtare për kufijtë

e Kosovës. Në biseda me Berishën dhe Kurtin ka qenë e ngrohtë, ku kanë biseduar rreth idesë së hedhur nga zyrtarët e lartë të Kosovës për ndryshim kufijsh. Lidhur me këtë çështje Berisha dhe Kurti janë shprehur publikisht se janë kundër kësaj ideje. Ish-kryeministri Sali Berisha ka

folur për herë të parë për liderin e Vetëvendosjes Albin Kurtin në "Zonë e lirë". I ftuar në "Zonë e lirë", Berisha u shpreh se Kurti është një kafshë politike. "Ai është një politikan, një figurë....unë do të them një fjalë që ndoshta në shqip nuk tingëllon mirë, por Albini është kafshë

politike. Kam pasur simpati të jashtëzakonshme për projektin e "Vetëvendosjes" për bashkimin kombëtar. Projekti që ai paraqiti është më fisniku më sublimi nga të gjithë."—tha Berisha ndër të tjera.

Sweet London RESTAURANT

www.sweet-london.co.uk

62A Longbridge Road,
Barking, Essex,
IG11 8RT

info@sweet-london.co.uk

02082625172



- Ambient festiv
- Ditëlindje
- Festa
- Takime rinore
- Studentë
- Gëzime familjare

**Ambient i rehatshëm për 60 vetë
Pasina komode me shisha për 50 vetë**

VILA RONEL



Vila Ronel Bar
& Restaurant
46 Birchington Road
London
NW6 4LJ

020 7624 1385

www.vilaronelrestaurant.co.uk

Reservation@vilaronelrestaurant.co.uk



RISHKUNDJA E “DIPLOMACIVE MEMORIALE” NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Nga Dr Fatmir Terziu

Rishkundja e memorjes në Ballkan është një detyrë e përhershme shtëpie, jo vetëm për shqiptarët, poltikanët, por edhe për të gjithë diplomatët dhe përfaqësuesit e medias. Kjo përbën anën themeltare të komunikimit, të krijimit të urave të reja të bashkëpunimit, gjithnjë duke zëvendësuar urrejtjen dhe mllefin, egon dhe brutalitetin. Kjo duhet, pasi po të kujtojmë nga kohët e fundit, gjithnjë duart e errëta veprojnë të prishin imazhet e krijuara në dobi të këtyre urave. Mosmarrëveshja e Preshevës e vitit 2013 nuk është e fundit, por ishte shumë më e keqja, me një numër në rritje të mosmarrëveshjeve në të gjithë rajonin, që tregonte se si memorjet e ndara dhe kontardiktore kujtonin të vdekurit e luftërave të viteve 1990. Më 14 Janar të vitit 2013 një përmendore për ushtarët e ushtrisë boshnjake të luftës në qytetin e ndarë të Mostarit u hodh në erë. Një pllakë kushtuar 13 janarit një atentatori pro-Bullgar në Shkup u raportua gjithashtu se u shkatërrua në atë që po bëhet një traditë sa herë që zëvendësohet.

Ndërkohë që ende ekzistojnë gjithashtu diskutime të hidhura rreth përmendoreve dhe çështjeve gjyqësore në lidhje me luftën e dytë botërore në këtë rajon, ajo që duhet mëshuar është domosdoshmëria e “Diplomacisë Memoriale”. Kjo vlen edhe për Preshevën e sotme, të cilën duket se heshtja e ka lënë në harresë, e ka mënjeluar edhe si arsye

nga “Memorja Diplomatike”. Presheva, mbetet kështu një qytet i vogël, dërrmues etnik shqiptar në jug të Serbisë, afër kufirit me Kosovën i mbizotëruar nga shqiptarët, një heshtje sa qytetare, aq dhe politike dhe diplomatike. Pas humbjes së vitit 1999 të serbëve në Kosovë nga NATO dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), një degëzim i saj, Ushtria rajon-çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovac (UÇPMB) filloi një mision në këtë pjesë të Jugut të Serbisë. Nga 90,000 njerëz që jetojnë në luginën e Preshevës rreth dy të tretat janë shqiptarë etnikë. Kryengritja e armatosur përfundoi në maj 2001.



Mbështetësit perëndimorë të Kosovës sqaruan se nuk do të mbështesin asnjë ndryshim të kufijve, dhe qeveria e parë e Serbisë pas Millosheviçit ishte e prirur të shmangte një konflikt të ri. Një marrëveshje u arrit dhe anëtarët e UÇPMB u amnistuan.

Konflikti kushtoi jetën e 18 policëve serbë, gjashtë ushtarëve dhe dhjetëra civilëve. Në anën shqiptare, shifrat ndryshojnë, por memoriali i luftës UÇPMB-

së i ngritur në nëntor 2013 shënon emrat e 27-të të vvarëve. Ndërsa shqiptarët i konsiderojnë ata si heronj, serbët i shohin ata si terroristë separatistë. Ka edhe përmendore të tjera të UÇPMB-së në luginën e Preshevës, por kjo veçohet sepse është ngritur para bashkisë. Më 11 Janar të atij viti, Këshilli lokal i mbizotëruar nga shqiptarët e Preshevës vendosi që monumenti të qëndrojë. Ivica Daçiç, kryeministri i asaj kohe i Serbisë, e ka quajtur memorialin një “provokim të hapur” dhe tha se ai duhet të priset deri më 17 janar të atij viti ose ai do ta shkatërrojë atë. Udhëheqësit lokalë

shqiptarë kishin bërë thirrje Shqipërisë zyrtare t’iu japë mbështetje diplomatike. Disa kërcënuan me një rebelim të ri nëse shkatërrohet monumenti.

Pra, 6 vjet më parë heqja e dhunshme e lapidarit të dëshmorëve të UÇPMB-së në Preshevë, nga ana e xhandarmërisë serbe, nxiti reagime në gjithë opinionit shqiptar. I menjëhershëm ishte reagimi i Qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të

Kosovës. “Qeveria Shqiptare dënoi aktin e largimit me autoblanda, mitraloza dhe terror, nga autoritetet e Beogradit, të përmendores së heronjve të kombit shqiptar në Luginën e Preshevës, që ranë për t’u bërë të pavdekshëm në luftë për liri e dinjitet njerëzor dhe kombëtar, kundër regjimit barbar të Millosheviçit”. Edhe Qeveria e Republikës së Kosovës shprehu indinjatën e saj të thellë për veprimin e shëmtuar të heqjes me forcë të Memorialit për luftëtarët e UÇPMB-së në qendër të Preshevës: “Ky veprim i Qeverisë së Serbisë është një dëshmi tjetër se urrejtja kundër shqiptarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës është ende gjallë dhe se ajo po ushqehet me veprime të tilla të pasardhësve të politikës gjenocidale të Millosheviçit”, thuhet në kumtesën për media.

Rrënimi i përmendoreve dhe ndalimi i shpalosjes së vlerave kulturore dhe i kujtesës historike të popujve, natyrisht është një dështim “diplomacisë memoriale”, por është dhe një thirrje për zgjim dhe gjakftohtësi, në mënyrë që qytetarët e kësaj treve të mos bien pre e provokimeve, sado të dhimbshme qofshin ato. Ndaj monumentet, ngjarjet që lidhen me to, bustet, figurat, varret dhe dëshmitë e tjera, kurë nuk zgjidhen me rebelime, me forcë, me jo-arsyetime, por me forma didakte dhe të pjekura diplomatike. E gjitha është dhe mbetet një udhë e pjekur, që vjen nga forma didakte e “Diplomacisë Memoriale”. Por si duhet dhe si funksionojnë këto diplomaci?

KURTI NË LONDËR, PRITET NGA ZYRTARË TË PARLAMENTIT TË BRITANISË

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ishte në vizitë dyditore në Londër. VV njoftoi se në Parlamentin e Britanisë është shtruar darkë për Albin Kurtin nga ana e Grupit të Miqësisë me Kosovën. Ky grup ka qenë në përbërje të, John Grogan, deputet i Partisë Laburiste dhe Martin Vickers, deputet i Partisë Konservatore, për nder të kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe të deputeteve Fitore Pacolli dhe Saranda Bogujevci. “Në darkë morën pjesë edhe Alex Sobel, deputet i Partisë Laburiste, Nick Dakin, deputet i Partisë Laburiste, Earl of Sandëich John Montag dhe Lordi Dykes. Në një atmosferë të ngrohtë e miqësore u shkëmbyen mendime e ide rreth situatës socio-ekonomike, politike e rajonale, si dhe për prioritetet e qeverisë Kurti”, thuhej në njoftim.

Takim me komunitetin shqiptar Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti realizoi një vizitë në Londër, ku zhvilloi dhe një takim me bashkatdhetarët që jetojnë në Britani. Pretendenti i LVV-së për kryeministër të Kosovës, gjatë vizitës u shoqërua edhe nga kandidatet për deputete Saranda Bogujevci dhe Fitore Pacolli. Ai tha se fitorja e tyre në Kosovë, ka jehonë edhe më të gjerë se sa vetëm Republika e Kosovës, apo kombi shqiptar. “Është dëshmuar se insistimi shumë vjeçar, shpaguhet atëherë kur je bashkë me qytetarët dhe e mban interesin e përgjithshëm mbi interesin e veçantë. Që do të thotë se e mban idealin dhe moralin në politikë. Unë nuk mendoj që ëndrra dhe realiteti janë të kundërta dhe as në kundërtënie me njëra tjetrën. E kundërta e ëndrrave nuk është realiteti, por iluzionet. Pra nëse shqiptarëve në periudha të caktuara historike,



iu kanë munguar ëndrrat, kjo sepse iu kanë tepruar iluzionet. E përfundimit më 6 tetor, populli i Kosovës, bashkatdhetarët tanë që votuan, qoftë me postë, qoftë duke ardhur në vendlindje, i flakën tutje iluzionet dhe e rifituan ëndrrën. Duke e rifituar ëndrrën, ata janë fare pran ndryshimit të realitetit, e për këtë gjë nevojitet një qeveri e re, çfarë do të jetë ajo e opozitës së deridjeshme, e me udhëheqjen e Vetëvendosjes, për t'i realizuar ëndrrat e mira të qytetarëve tanë t'Ë « Republikës », tha mes tjerash Kurti.

Kurse kandidatja për deputete

e LVV-së, Fitore Pacolli ka theksuar se është pikërisht Londra, ajo që ka ndikuar në orientimin e saj politik, pasi aty ka dëgjuar një ligjëratën të Albin Kurtit, i cili ka arritur si asnjë lider tjetër politik ta bind për t'iu bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje.

“Prej krejt kontakteve që unë kisha arritur më i bë në Londër të politikanëve që unë i kisha taku, asnjë politikan nuk më pat dhënë një mesazh të qartë që duhet ta kemi si lider në Kosovë për veç Albin Kurtit. Unë pata vendos që t'i bashkohem Lëvizjes Vetëvendosje për derisa isha në Londër”, tha Pacolli



 **POEM**
Bar & Grill

AVAILABLE FOR HIRE
120 ADULTS & 60 CHILDREN

NË VJENË U HAP TURNEU NDËRKOMBËTAR NË SHAH "ARBËRIA OPEN 2019"

Nga Besim Xhelili, Vjenë

Në datat 21-27 tetor 2019, shahistë të ndryshëm nga 14 nacionalitete, por edhe adhures të tjerë të këtij sporti, kanë rastin të kalojnë bashkë çaste të mira sportive, si dhe të argëtohen përgjatë lojërave të shahut. Klubi i Shahut "Arbëria" si nikoqir, në bashkëpunim me Federatën e Shahut të Vjenës, urojnë sportistët për suksese, ndërsa vizitorëve u dëshirojnë mirëseardhje dhe të kalojnë bukur. Tash e shtatë vjet nga themelimi, Klubi i Shahut "Arbëria" nga Vjena, po kontribuon vazhdimisht me aktivitetet sportive e kulturore, duke organizuar takime të rregullta me anëtarët dhe lojtarët, por gjithashtu duke organizuar edhe kohëpaskohe turne të ndryshëm, nisur nga ato me rastin e manifestimeve tradicionale në shkurt dhe nëntor, dhe për raste të tjera në bashkëpunim me klube e shoqata të tjera. Klubi përgjatë kësaj kohe

ka arritur të korr suksese të shumta, duke u ngjitur thuajse gati çdo vit në një ligë më sipër, në kuadër të Ligës së Shahut në Vjenë. Ai tash garon me dy grupe, atë A, më profesionistët dhe me grupin B dhe ka shahistë nga disa nacionalitete. Pas sukseseve të shumta, kryesia e klubit diskutoi me anëtarët hapin e madh dhe të rëndësishëm që ishte planifikuar. Bëhej fjalë për mbajtjen e një turneu ndërkombëtar nën patronazhin e klubit dhe në bashkëpunim me Federatën e Shahut të Vjenës. Pasi u bënë të gjitha përgatitjet e nevojshme, të hënën, më 21 tetor, në lokacionet e Federatës së Shahut të Vjenës, u hap solemnisht turneu dhe nisën lojërat. Shahistë nga 14 nacionalitete me banim në Vjenë, përgjatë një javë do të masin forcat e tyre mes veti, edhe atë duke bërë nga 7 lojëra, sipas sistemit zviceran. Hapjen e turneut e bëri sekretari i klubit Anton Marku, i cili pasi përshëndeti përzemërsisht garuesit dhe



të pranishmit, u shpreh se u gëzohet sukseseve të klubit dhe se ky turne ndërkombëtar është gjithashtu një nismë e duhur, që të gjithë, pa dallime nga prejardhja apo bindjet, gjinia ose grupmosha, kanë rastin bashkë të luajnë shah, të argëtohen dhe të njihen mes veti. Ai falënderoi Federatën e Shahut të Vjenës për mbështetjen dhe lokacionet e ofruara për këtë turne. Hapjen e turneut e nderoi me pjesëmarrjen e tij Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Austri, z. Roland Bimo. Në fjalën e tij përshëndetëse ai me shumë admirim foli për arritjet e klubit "Arbëria". "Larg nga dinamika dhe stresi i përditshmërisë, ju këtu kaloni kohën tuaj të lirë duke u argëtuar mes

veti, jam tepër i lumtur që shoh edhe pjesëmarrës të gjinisë femërore si dhe fëmijë entuziastë, dhe besoj e uroj të arrini suksese përgjatë kësaj jave sportive. Klubit "Arbëria" i dëshiroj edhe më shumë suksese dhe aktivitete të tilla, që lidhin popujt dhe kulturat e ndryshme", tha z. Bimo. Pjesëmarrës në hapjen e turneut ishte edhe vetë kryetari i Federatës së Shahut të Vjenës z. Johannes Pöcksteiner, i cili gjithashtu me një fjalë rasti përshëndeti të pranishmit. Për mbarëvajtjen e turneut do të përkujdeset gjyqtari z. Gregor Neff, kurse për fituesit janë paraparë çmime në vlerë monetare, kupa dhe mirënjohje si dhe çmime në gjësende.



+




PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE

PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45

“PRIZRENI LONDON CAFÉ” TRADITA E BUKUR SHQIPTARE



“Prizreni London Café” është një dyqan i njohur në 23 Vivian Ave, London NW4 3UX UK. I njohur si çelësi në prodhimin e ushqimit të cilësisë dhe takeaways, shërbime restaurant, dyqan kafeje, dhe grill. “Prizreni London Café” natyrisht që vjen para klientëve të shumtë nga e gjithë Londra me traditat më të mira shqiptare.

Byrekët e shijshëm me mish e me gjizë, qepë e me domate, të freskët e të gatuar nga profesionistë të kësaj tradite shqiptare, kebabat, apo qoftet e shkëlqyera dhe mjaft tradicionale shqiptare të gatuar nga mjeshtri i tyre, Asllani dhe stafi i kualifikuar prej tij, pra si Coffee Shop -

Coffee Grill - Takeway, Byrekë specialë, Qofte tradicionale, Pica të ndryshme e mjaft të tjera që e bëjnë këtë vend të jetë më i frekuentuari dhe më i kulturuar në zonën e Hendon Central në Londër.

Asllan Kureqi është modest dhe flet pak, por është specialist dhe shumë i përkushtuar ndaj profesionit të tij të dashur. Ai mund të kontaktohet në lokalit etij me Telefonin: +44 2082026846 dhe me E-Mail: asllankureqi@gmail.com. Ju bëjmë me dije se “Prizreni London Café” ndodhet në Adresa: 23 Vivian Ave, London NW4 3UX, UK.

Por ajo që e bën më tradicionale dhe profesionale këtë vend është pastërtia,

kultura dhe respekti. Byreku është vlerë nvërtet më vete. Shije e padiskutuar. Byreku apo Bureku (shpesh edhe Lakror) është një gatesë që bën pjesë tek brumërat e pjekur e të mbushur, i përgatitur nga petë të holla të njohura si filo. Byreku shumë i popullarizuar në kuzhinat e vendeve të ish Perandorisë Osmane, tashmë është në tërë origjinalitetin e tij edhe këtu nga duart e mjeshtrit Asllan. Dhe pse, sepse Byreku është pjesë e kuzhinës tradicionale shqiptare të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë

dhe trojeve tjera shqiptare dhe përgatitet në variante të ndryshme. Ai mund të shërbehet i ftohtë ose i ngrohtë.



Prizreni London Café



Prizreni London Café është i njohur si çelësi në prodhimin e ushqimit të cilësisë dhe takeaways, shërbime restaurant, dyqan kafeje, dhe grill.

Prizreni Café me traditat më të mira shqiptare
Coffee Shop - Coffee Grill -
Takeaway
Byrekë specialë
Qofte tradicionale
Pica të ndryshme



+44 2082026846

asllankureqi@gmail.com

23 Vivian Ave,
London NW4 3UX, UK

“DOING BUSINESS 2020” RENDIT SHQIPËRINË

Shqipëria shënoi përparim minimal në raportin Doing Business 2019, duke kërcyer vetëm dy radhë në krahasim me një vit më parë. Shqipëria renditet në vendin e 63 në mesin e 190 ekonomive në Bankën Botërore Lehtësia e Bërrjes së Biznesit. Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, performanca e përgjithshme e vendit në këtë indeks është më e mirë se Bosnja dhe Hercegovina, e 89-ta. Ndërkohë, Maqedonia shënoi pozicionin më të mirë pasi renditet në vendin e 10, e ndjekur nga Kosova e 40-ta, Serbia e 48-ta dhe Mali i Zi i 50-ti.

Por “Doing Business 2020” ka renditur të fundit në Europë për klimën e të bërit biznes. Nga raporti i Bankës Botërore dalin Shqipëria, Bosnja dhe Malta. Shqipëria u rendit në vendin e 82 në rang global, me një rënie 19 vende krahasuar me vitin 2019. Përveçse Shqipëria është e fundit në Europë, renditet edhe ndër vendet me përkeqësimin më të lartë të klimës së biznesit brenda një viti.

Nga 10 indikatorët e marrë në studim shihet se përkeqësimin më të madh e shënoi në mbrojtjen e investimeve. Vitin e kaluar, Shqipëria u rendit në vendin e 26 për mbrojtjen e investimeve, ndërsa këtë

vit u rendit në vendin e 111. Ky është indikatori më i rëndësishëm për investitorët e huaj. Për një vit, shihet se vendi ka rënë në renditje me 85 vende në raport me një vit më parë.

Përkeqësim shënoi edhe indikatori tjetër që ka të bëjë me investimet, “mbrojtja e kontratave”.

Vendi ynë humbi këtë vit 22 vende në renditje në raport me vitin e kaluar. Indikatori prej të cilit jemi penalizuar prej vitesh, lejet e ndërtimit, ka pësuar përkeqësim të mëtejshëm. Këtë vit, Shqipëria renditet në vendin e 166 nga vendi i 151 që ishte një vit më parë.

Siç shihet nga grafiket e

mëposhtëm, vendi ka shënuar përkeqësim në të 9 indikatorët nga 10 gjithsej.

Banka raportoi se Shqipëria pati përmirësim në besueshmërinë e furnizimit me energji duke përdorur një sistem automatik të kontrollit mbikëqyrës dhe përvetësimit të të dhënave (SCADA) për monitorimin e ndërprerjeve dhe restaurimin e shërbimit.

Banka raporton se, reformat në pagimin e taksave të përfshira në Doing Business 2020 janë ato të zbatuara në vitin kalendarik 2018 (1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018).



PETICION I DIASPORËS SHQIPTARE PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË EUROPE

Dr. Luan Zyka është nismëtar i një Peticioni drejtuar: Kryetarëve dhe Kryeministrave të shteteve anëtare të Bashkimit European dhe Këshillit të Europës. Për dijeni: Parlamentit të Europës; Presidencës së Këshillit të Europës; Komisionit European; Parlamentit të Republikës së Shqipërisë; Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Tema e peticionit është: Thirrje e shqiptarëve të diasporës për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European

Të nderuar Shkëlqesia Juaj, Kryetarë dhe Kryeministra të shteteve anëtare të venvdeve të Bashkimit European!

Politika e zgjerimit të Bashkimit European rezultoi vendimtare, jo vetëm në reformimin politiko-ekonomik për të gjitha vendet që tashmë janë anëtare të tij, por edhe duke shërbyer si forcë tërheqëse për vendet dhe popujt që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin European.

Populli shqiptar që jeton prej lashtësisë në një zonë gjeografike, historikisht udhëkryq i interesave të kundërta globale dhe kulturave të ndryshme, asnjëherë nuk e humbi shtratin e tij kulturor, thellësisht dhe tërësisht european.


Orientimi ndaj ideve europiane përbënte një konstante bazë që në krijimin e shtetit shqiptar dhe

zhvillimin e tij kulturor. Edhe në periudhën kur ideologjia e tij shtetërore ishte totalitare komuniste, shqiptarët e ndanë fatin e tyre nga koalicionet politiko-ushtarake jo europerëndimore, edhe pse me kosto të lartë për jetën dhe vendin e tyre.

Populli shqiptar e rrëzoi sistemin antidemokratik dhe diktatorial i frymëzuar nga idetë europerëndimore me thirrjen historike "E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Ishin këto ide që frymëzuan dhe orientuan popullin shqiptar në udhën e hyrjes në familjen e madhe europiane. Ishin këto ide demokratike, të cilat së bashku me ndihmën e vendeve fqinje europiane, të Bashkimit European dhe vendeve të tjera perëndimore, përbënë shtyllat e stabilizimit ekonomiko-politik të Shqipërisë, dhe tashmë janë në themel të modeleve politike, ekonomike, juridike dhe institucionale të popullit shqiptar me synimin final anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European.

Të qartë për rrugën e zgjedhur, të vetëdijshëm për sakrificat e kryera, por të vendosur në synimin e tij final, shqiptarët kanë bërë shumë reforma për të përmbushur dhe zbatuar kriteret e Kopenhagenit dhe Madridit.

Rruga e demokratizimit të Shqipërisë e kryer deri tani ka kaluar mes peripecive të ndryshme, dhe populli shqiptar duhet nxitur dhe ndihmuar për të lënë pas të shkuarën e dhimbshme, gabimet e tij, por



edhe gabimet e Europës dhe Fuqive të Mëdha.

Populli dhe kombi shqiptar, duke respektuar fqinjësinë e mirë dhe duke tejkaluar anakronizmat historike, po kontribuon në paqen dhe stabilitetin rajonal duke zgjedhur fatin e zhvillimit të tij brenda familjes së madhe europiane.

Shqiptarët janë të vetëdijshëm se procesi i demokratizimit të vendit dhe i aftësisë së tij për të qenë një anëtar i denjë i Bashkimit European, do punë dhe kohë akoma.

Çdo vonesë apo pengesë në këtë proces historik mund të shkaktojë gabime dhe fatalitete me kosto jo vetëm për Shqipërinë dhe kombin shqiptar, por edhe për zonën

delikate të Europës Juglindore dhe më gjerë.

Ne, bijtë e bijat e shqiptarëve, që tashmë jemi integruar në shoqëritë europiane, duke dhënë ndihmesën tonë në zhvillimin tërësor të tyre, përbëjmë një shembull bindës për aftësitë e shqiptarëve për të përvetësuar dhe vepruar si të barabartë në trupin e shoqërive europiane.

Ne, diaspora shqiptare, që përbëjmë me qindra mijëra anëtarë në të gjitha vendet e Bashkimit European, përveçse jemi një shembull qytetarie në vendet që na kanë hapur dyert e jetës, gjithashtu do të jemi përkrah dhe garant për të ndihmuar atdheun tonë në demokratizimin dhe europeanizimin e tij.







Koha e fillimit : _____
Koha e mbarimit : _____
Koha e zënë : _____

ZBULONI SILUETËN

Gjejini figurat duke bashkuar pikat!



SUDOKU



Koha e fillimit : _____
Koha e mbarimit : _____
Koha e zënë : _____

SUDOKU I MESEM

		3	5		9	
8						3
2	7		3			
		5	8		6	
4			6	5		2
	2		9	1		
				4	1	9
7						4
	8		7	3		

SUDOKU I LARTË

1	5		6	8		9	3
		9		4		6	
4				9			5
			3	6			
5	6	8	1	4	3		2
6							9
7			9	1			4
	8		4	7	3		

A DO TË NDËRTOJË NATO BAZË DETARE NË SHQIPËRI?

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, tha se aktualisht Aleanca e Atlantikut të Veriut nuk ka një projekt për të ndërtuar një bazë detare në Shqipëri, por shtoi se çështja do të diskutohet dhe do të merret një vendim.

Disa ditë më parë, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka përmes një letre zyrtare e ka prezantuar komandantin e Komandës Supreme për Europën, gjeneralin amerikan Tod D. Wolters me planin e qeverisë shqiptare për modernizimin e bazës detare të Pashalimanit, me qëllim përdorimin e saj nga Aleanca. Xhaçka ka shprehur gatishmërinë e palës shqiptare për hartimin dhe zbatimin e një plani të përbashkët me NATO-n për zhvillimin e mëtejshëm të bazës detare, konform standardeve të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Stoltenberg, i pyetur për këtë çështje gjatë një konference të përbashkët për shtyp me



Presidentin e Ilir Meta në Bruksel, tha se “kërkesa që na është bërë është e rëndësishme për Shqipërinë, por edhe për NATO-n. Ne kemi një program aktualisht që po punojmë për një bazë në Shqipëri (Baza ajrore e Kuçovës). Për momentin nuk

kemi një projekt për një bazë detare, por do të diskutohet dhe do të merren vendime.” Presidenti Meta nga ana e tij tha se ka “folur me Sekretarin e Përgjithshëm për vazhdimësinë e zgjerimit të BE në rajon, sepse NATO dhe BE janë të lidhura për shkak

të qëllimeve dhe natyrisht kemi shprehur pakënaqësinë për mungesën e vendimit për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Jemi të vendosur të dyfishojmë përpjekjet tona në këtë drejtim.”

BIG BOSS SERVICES
(UK) LTD
BUILDING CONTRACTORS

Instagram: [big_boss_services_uk_ltd](#)
Twitter: [@BigBossServices](#)
Facebook: [BigBossServicesUKLtd](#)

OUR SERVICES INCLUDE:

Guttering	PVC Windows	Plastering
Painting	Loft Conversion	Carpentry
Decorating	Extensions	Roofing
Power Clean	Kitchen Fitting	Brickwork
Scaffolding	Bathroom Fitting	Tiling



Tel: 020 8591 9198

Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474

Email: bigboss.services@yahoo.co.uk

website: www.bigboss-service.webs.com

UTR: 7168616298

CRN: 8344897

VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës, Tiranë dhe ne zonën e plazhit deri tek Mali i Robit

Kontakt: 07883029474 dhe 00355685309800

BIBLIOTEKA E PEJËS, INSTITUCIONI ME RËNDËSI TË VEÇANTË KULTURORE DHE ARSIMORE

Nga Sherif Billaca

Biblioteka Rajonale "Azem Shkreli" në Pejë, është njëra prej institucioneve më me rëndësi kulturor dhe arsimor, e cila u themelua qysh në kohën e perandorisë osmane, respektivisht, sipas shënimeve që disponon biblioteka, në vitin 1836. Kjo, bibliotekë, në atë kohë, sipas të dhënave u themelua në periudhën osmano-franceze, dhe prej asaj kohe bëhet vatër e arsimimit, e librit dhe e diturisë, për t'u zgjeruar pastaj në një qendër të rëndësishme ku janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme letrare dhe ku kanë zënë dituri shumë kuadro të njohura jo vetëm në Pejë. Mirëpo, me zhvillimin dhe me ndërrimin e periudhave kohore dhe politike e historike, biblioteka e Pejës, ecën bashkë me kohën, gjatë të cilave ka pësuar edhe ndryshme. Mirëpo, përkundër sunduesve dhe pushtuesve të ndryshëm, ajo gjithnjë ishte vend ku dituria dhe mësimi bëheshin faktorë me rëndësi duke e përqaftuar rolin e librit, pa marrë parasysh gjuhën apo edhe literaturën që dominonte.

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, biblioteka e Pejës, luante një rol të veçantë në kompletimin e dituri dhe njohuri arsimore, kulturore dhe shkencore. Ndërsa, krahas kësaj, përmes bibliotekës, organizoheshin edhe manifestime të shumta kulturore. Ndërkaq, pas luftës së fundit në Kosovë, duke pasur parasysh rëndësinë shkollimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja, por edhe të studimeve shkencore, në vitin 2002, biblioteka e qytetit të Pejës organizohet, dhe merr emrin e një krijuesi të devotshëm të letrave shqiptare

dhe të një intelektual, i cili vjen nga kjo komunë, nga ky qytet, pra emërtohet "Azem Shkreli".

Pas luftës, biblioteka u vendos në lokalet e shoqatës së pensionistëve

Fillimisht, duke pasur parasysh se Shtëpia e kulturës, pas luftës ishte në funksion të organeve ndërkombëtare që vepronin në Kosovë, respektivisht të Policisë së UNMIK-ut, biblioteka u vendos në ambientet e Shoqatës së Pensionistëve, e cila në atë kohë bukur shumë i plotësonte kushtet për punë normale. Kjo, ngase, në dispozicion ishin disa hapësira për vendosjen e librave, dhe çfarë ishte më me rëndësi, ishte salla shumë e përshtatshme për organizimin e manifestimeve kulturore dhe letrare, siç ishin orët letrare dhe promovimet e librave. Po ashtu, kjo sallë ishte e përshtatshme edhe për sallë leximi për të gjithë ata që dëshironin të mësonin në ambientet e bibliotekës. Kështu, për një kohë të shkurtër, radhët e organizimit

të punës u konsoliduan bukur shumë, dhe tani një numër i madh lexuesish u anëtarësuan për tu pajisur me literaturë dhe lektura shkollore. Vlen theksuar se pas luftës, biblioteka e Pejës, nuk kishte më shumë se 16. 550 libra, një pjesë e të cilave edhe ishin dukshëm edhe të dëmtuar. Mirëpo, kohë pas kohe, me mbështetjen e qeverisë së pasluftës por edhe të qeverisjes lokale si dhe të shumë krijuesve e qytetarëve, fondi i librave shtoej prej dite në ditë.

Biblioteka tani është e vendosur në Shtëpinë e Kulturës të qytetit të Pejës

Siç thekson udhëheqësja e këtij institucioni, znj. Shengyl Kelmendi Gashi, kushtet në ambientet e Shoqatës së pensionistëve, tanimë nuk ishin adekuate për punë normale dhe profesionale, kurse dukshëm fondin e librave e dëmtonte edhe lagështia që i përfshinte lokalet e këtushme.

Tani, edhe në Shtëpinë e Kulturës, kushtet nuk janë edhe

aq adekuate për punë normale, sepse, numri i anëtarëve dhe i lexuesve, prej dite në ditë po shtohet, kurse tri salla, të cilat edhe pse janë të pajisura bukur mirë, nuk mjaftojnë për punë komode dhe për lexim e studim të rehatshëm.

Biblioteka, edhe pse momentalisht disponon me mbi dyzet mijë libra të strukturave e të degëve të ndryshme, nevojat janë që numri të shtohet gjithnjë e më shumë. Tani, kjo qendër e diturisë, disponon me mbi dhjetë mijë libra si literaturë, njëzet mijë beletristikë dhe me afro dhjetë mijë libra shkencorë.

Prandaj, tani biblioteka ka tri lloj shërbimesh: për nevojat e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, për studentë dhe për ata që merren me studime shkencore. Kjo, deri diku edhe ka shtuar interesimin e anëtarëve të rinj. Ndoshta, një gjë e tillë ka ndikuar, sepse, këtu sidokudo kushtet janë më të volitshme edhe për të mësuar, por edhe për të arritur dituri në fushën e studimeve.



TË PAPRITURAT E NJË UDHËTIMI, ISTOG - PEJË

Nga Kadri Tarelli


Mëngjes i të dielës në Istog, në Kosovë. Freski mali, në mes të vjeshtës së parë, 2019. Buzëqesha me vete, kur po rregulloja kravatën, sepse përvoja dhe njohuritë gjeografike më ndihmuan të jem i kujdesshëm, që të marr xhakët. Qyteti ende në gjumë. Rugët ishin bosh, asnjë kalimtar, ndërsa për lokale kafeje, as që bëhej fjalë. “Ky qytet paska marrë huqet e Europës dhe banorët bëjnë jetë nate”, - bëra shaka, por nuk më dëgjoi njeri. Pasi e përshëndeta të parin person që takova, e pyeta se ku mund të gjej taksi për të udhëtuar drejt Pejës, pasi siç mora vesh, të dielave autobusi urban nuk punon. Të them të drejtën, ende nuk më dilte inati, nga një pakujdesi e vogël në dukje. Çudi! – Përsërita për të disatën herë, pa gjetur përgjigjen e duhur. -Njerëzit nuk paskan nevojë të udhëtojnë të dielave? A thua të jenë të gjithë zyrtarë? Kështu po i blujaja mendimet dhe po grindesha me vete, në këtë mëngjes të freskët Istogu. Pas gjysmë ore pritje, tek këmbët e mia ndaloi një makinë

e vogël me ngjyrë të kuqe. - Hajde Profesor hip në makinë! Besoj se do të shkosh në Pejë! Hipa në makinë, dhe nuk i kushtova vëmendje thirrjes, “Profesor”, duke menduar, se shoferi e pati të lehtë të gjejë një emër, duke u nisur nga të qenit jabanxhi dhe, nga veshja si për takime akademike. Gjithsesi më erdhi mirë, që ai nuk veproi si të tjerët, që më thonë gjysh, apo zotëri. Për të hapur bisedën, fillova të ankohej, pse të dielave nuk punon linja e autobusëve, duke renditur pasojat e këtij gjykimi, që nuk përfill interesat e udhëtarëve dhe hallexhinjve, gjithmonë sipas mendimit tim. Unë kam miq në Pejë, të cilëve mund t'i bëj një telefon dhe vijnë e më marrin, sepse do të udhëtoj drejt Shqipërisë dhe kohën nuk e komandoj dot. Po a mund t'i thërras për kaq copë rruge? Hë, si thua ti? - Shoferi më dëgjonte dhe me buzën në gaz, miratonte lumin e fjalëve të mia. Pasi unë ndalova një çast, sikur prisja përgjigje, ai më pyeti: - Ç' kemi nga Durrësi? - Ishte një pyetje, sa për të ndërruar bisedën. - Si gjithmonë vapë dhe plazh, pavarësisht se është mesi i shtatorit, - u përgjigja shpejt,



duke kthyer kokën ta shikoj më mirë në fytyrë këtë shofer, që, si me kursim, po më jep të njohur. Nuk më kujtohej fare, që mund ta kisha takuar kund. Shtypa “butonin” e kujtesës dhe po kërkova në internetin e saj. “Vallë ku e kam takuar këtë njeri....?”, - thosha me vete. Mbase ndonjë nxënës Kosove, i shpërngulur nga lufta njëzet vjet më parë, si shumë të tjerë dhe ardhur në shkollën “Bajram Curri”, në zonën e Plazhit në Durrës, ku unë isha drejtor! Apo ndonjë vullnetar i luftës së Kosovës, që vinin dhe shkonin tek hotel “Drenica”, buzë detit në Plazh, që ishte bërë qendër, ku grumbulloheshin dhe niseshin për në luftë. E pa mundur! Këtu e dhjetë vjet më parë, unë kam takuar një pjesë të

tyre, kur erdhën të përkujtojnë dhe festojnë dhjetë-vjetorin e fillimit të luftës dhe çlirimit të Kosovës, por këtë njeri jo, jo! Nuk më kujtohet, diku tjetër mund ta kam takuar. Mbase..., mbase..., mbase....! - Vrisja mendjen dhe nuk po i bija në të. Kujtesa nuk po më ndihmonte. Ai më shikonte në pasqyrë dhe po kënaqej me përpjekjet e mia të kota, ndaj vazhdoi: - Mbiemrin ta mbaj mend, Tarelli ta thonë, por emrin e kam harruar tani për tani. – Përsëri një gjysmë njohje, mendova. - Eu bre burrrë! Ti po më njeh dhe unë jo! S'besoj se jam aq plak....! -I thashë duke qeshur, por me habi të shtuar. - Mos e lodh veten, që nuk po më sjell në kujtesë! Janë më shumë se njëzet vjet të shkuar, kur unë isha djalë i ri dhe ndihmoja për sistemimin e bashkatdhetarëve të mi, të ardhur nga Kosova, në ato vite lufte me Serbin. Unë me disa shokë, të gjithë shqiptarë të Kosovës, jemi takuar tek shkolla “Bajram Curri” në Plazh, pasi na duhej të rregullonim edhe nxënësit tanë, që mos rrinin rrugëve. Mbaj mend, se në mjediset e shkollës janë zhvilluar disa takime, madje edhe me zyrtarë të lartë të shtetit shqiptar. Ju ishit i pranishëm dhe na ndihmuat shumë, pasi i kërkonit vetë nxënësit, për t'i afruar në shkollë.



10 DITËT E LONDRËS

Nga Miho Gjini

Sapo e mbylla “siparin” e 10 ditëve të Londrës e gjithçka më mbeti në sy si një vegim, më përtej ëndrrave. Gjithçka që si një “trill” i sime bije, mbetur qyshkuri ajo nisi të dalë nga vetja, për të mbetur gjithmon brënda vetes, në krijimin e personalitetit. “Mos më thuaj ç’të bëjë, baba...Rrugën e jetës do ta zgjedh e do ta realizoj vetë!” Dhe ja tek jemi tani në rrugët e Londrës, tok me “Arëzën” e jetës time, tek soditim “Luanët Britanikë” në Qendrën e këtij qyteti pa anë e fund, që mba në “gjirin e vet” tetë milionë banorë. Për të ardhur deri këtu, na duheshin tri orë e gjysmë “fluturim” nga Aeroporti “Venizellos” i Athinës deri ne Aeroportin e Londrës “Heathrow”, si edhe (pas një dite), një orë kohë, që nga High Wycome, me makinë, pastaj me tren e me metro, që më von “të kurdisje këmbët”, për të bërë me to 10 mijë km. rrugë, që të paktën të shohësh diçka nga ky kryeqytet, nga më të lashtët e më të bukurit e botës, pa ane e pa fund. Se, në çdo hap që hedhë më duket sikur shkel gjurmët e hapave të dikurshme të Shekspirat e të Çarli Çaplini, të Bajronit e të Eduard Lirit, të Dikensit e të Bernard Shout, të Lorenc Oliverit, Ben Hillit e Mister Binit, të Çurçillit e të Margaret Theçerit. Të “luan kapaku i kokës”! Fillimisht, makinën e markës “Pezho” do ta ngiste një vajzë e re në moshë, e re në timon, një shofere piqerasiote, që është ime bijë. E sigurt në timon tashmë dhe e qetë. Ajo e di se ku na shpie..Dhe unë do të shihnja tani, me “bishtin e syrit” një tjetër vajzë, shumë më të pjekur, atë, të diplomuarën në Universitetin “Cardiff” të Uellsit, tashmë edhe “bijë e Londrës” gjithashtu, ku ka nisur të punojë për të mbrojtur Masterin... Rruga me tren, dukej sikur “çante” gjelbërimin e një pylli të dëndur e të pafund. Pastaj do të hynim në thellësitë e tokës, ku lëvrinin mistershëm qindra trena, drejt të gjitha skajeve të

Londrës, për të dalë diku edhe në qendrën e saj mahnitëse. Mbetesh pa gojë!. Ajo na rrëfen Pallatin Madhështor të Mbretëreshës, na fotografon përpara luanëve të atjeshm, që duket sikur mbajnë mbi shpinë obeliskun e Sheshit Kryesor, perball Mbretëreshës, për të hyrë mandej në Parkun e Madh përmbri Pallatit të Madhërisë së saj.. Më tej do të hysh në rrugët e ngushta me kalldrëm të Londrës së vjetër, aqsa do të të duket sikur do të të dalë përpara personazhi i Dikensit Oliver Tuist, prej basifondeve të hershme, derisa të duket bregu i Tamizit, ku do të të shfaqet menjëherë Teatri “GLOBUS” i Shekspirat dhe vet Shekspiri, me gjithçka mahnitëse që krijoi pesë shekuj më parë... Qe mesditë dhe aty shfaqej komedia “Endërr e një nate vere”, për të cilën më patën blerë një biletë një muaj më përpara, për të më mahnitur me Mjeshttrin Anglez të tragjedive e të komedive të tij të përjetshme, m’u në “shtëpinë” e vet, në skenën që ai e ideoi dhe e mbajti me ladinë e vet të krijimit.Tashmë lumi Tamiz s’ka të bëjë fare me Tavernat e Ser Xhon Fallstafit, personazhit të famshëm të Shekspirat, po me shëtitore nga njera anë dhe me grandaçela e kulla mahnitëse nga krahu tjetër, ku është derdhur paraja e botës mbarë. Dhe do të dalësh befaz në Urën Westminster, që lidhë të dyja brigjet e lumit të mbushur me anije të vogëla, skafe luksoze e gondola të panumërta. Prej këtu mund të shohësh Ndërtesën Gotike të Parlamentit Britanik, ku ma siguri Kryeministri Boris flet i nervozuar për miratimin e Brexit, si edhe kullën e orës “Big Ben”. Për t’u shlodhur në Sheshin Westminster, me një kafe përpara, duke u trullosur nga pamjet filmike të “lumit njerëzor” të të gjitha racave të botës. Dhe, për të ndalur më mbrapa, përpara Muzeut Britanik të Artit Pamor, ku vërtiten mijëra vizitorë që fotografohen tek shatërvani e mbi Luanët prej bronxi. Mëndja e njeriut ndalet, përpara së

madhërismes që rrok syri, në shkallaret e pafundme ku janë ulur mijëra njerëz e pak më tej, ku aktrojnë artistët e rrugës, interpretojnë muzikantët, xhonglerët dhe bëjnë marifetet e tyre bixhozçinjtë. E duhet t’i mënjanojnë tërë këto pamje, për të hyrë në botën shpëtimtare të artit të vërtetë, që mba brënda vetes, ky Muze i Famshëm i thesareve të artit pamor nga e gjithë bota. Vetëm këtu mund të provosh stepjen e humbjen e vetëdijes, nga magjia e artit të pikturës, sidomos prej mjeshtrove italian, spanjoll, francez të rilindjes së njerëzimit e më tej... Gjithçka si nëpër përralla është edhe jashtë Londrës, në qytezat e rrethinat, ku do të të duket sikur këtu nuk banojnë njerëz, po janë vetëm ketrat që hypin e zbresin nga pemët e shumta, pa patur frikë prej njerëzve, sorkadhe të vogëla që kanë humbur “prindërit” e që duan të kapërcejnë rrugët e makinave. E, as makinat nuk i ndjen udhëtari kurjoz që vjen nga larg, sepse askush nuk i bie borisë. Gjithkush respekton rregullat e qarkullimit, ligjet, normat, etikën qytetare. E gjithçka përreth është e pastër, pa asnjë letër e mbeturinë nëpër rrugë, në një qytetërim të rangut të lartë, ku të pamësuarit

mbeten pa gojë, si të shushatur. Do të shohësh pemë shekullore ngado që hedhë syri e ku askund nuk “bie zjarri” prej keqdashësve e keqbërësve, “tunele” të gjata të sajara nga harlisja e pemëve shekullore, shtëpia të pastëra një e dy-tri katëshe, me konstruksione druri apo prej druri e tullash të kuqe, me pak lidhje hekuri e fare pa beton në përdorimin e përgjithshëm, deri sa del në qytezën Marlow, një tjetër mrekulli, që ruan me fanatizëm traditën e vet arkitekturore dhe tërheq turistë të panumërt, ku vijnë edhe notarë nga e gjithë bota për garat e kanotazhit. Këtu do të përballesh me urën “Buda-Pesti” dhe me kishën e hershme katolike, tek “këmbët” e saj, ku vinte të falej Mbretëresha Geraldinë, ndërkohë që i biri shihte filma në kinemanë e qytezës, gjatë kohës së strehimit të Mbretit Zog në qytezën Parmoor, në afërsi të Londrës..Dhe një drekë e mirë në Tavernën “George & Dragon” do të të sjellë në vete prej endjeve nëpër brigjet e lumit, me nga një gotë verë Spanjolle “La Riada” (Tempranillo), shoqëruar me meze të zgjedhura. Ne krye të tyezës tonë shkruhej: “Gjella pa verë është si dita pa diell”. E jashtë, për habi shkrep Dielli!



KU ËSHTË DHE KU DUHET TË ISHTE SOT SHQIPËRIA

Nga Vilhelme Vrana Haxhiraj

Kam 17 vite që jam marrë me studimin e veprave të botuara në shqip të eruditit, filozofit, njërit nga 7 më të mëdhenjtë e shek XX -të Prof.Dr. Isuf Luzaj. Sa më shumë e lexoj, apo e studioj këtë kolos mëndjendritur që ka ditur të bashkojë mendërisht dhe shkencërisht me fije të padukshme të gjitha epokat duke ia përshtatur realitetit të sotëm kombëtar, sa më tepër përqëndrohem, sa herë rikthehem, sa e sa herë e punoj për të zbërthyer vlerat e tyre që ato të kuptohen nga lexuesit e çdo niveli kulturor, apo sa më shumë thellohem në njohjen sadopak të veprës madhore të Prof.Dr.Luzit, aq më shumë bindem se deri tani, ai është një thesar i paçmuar dhe i padiskutueshëm i kulturës së kombit. Por për fat të keq është fare pak i njohur ose aspak i njohur veçanërisht për pushtetarët. Ndryshe Shteti, me autoritetin e vet, do ta kishte transferuar Bibliotekën e tij madhore nga ShBA në Shqipëri, sepse është një vlerë kombëtare për të cilën ka nevojë e sotmja dhe e nesërmja e kombit. Kjo prurje do të bënte të mundur që hulumtues dhe studiues të veçantë të filozofisë, sociologjisë, estetikës, etikës, historio-grafisë, gjuhësisë e të politikës do të merreshin me redaktimin dhe me botimin e gjithë asaj pasurie kulturore, gjithmonë nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës. Fatkeqësisht duke mos njohur veprën e tij, politikanët e këtyre 26 viteve nuk ia dinë vlerën, por nuk dinë edhe një gjë se sa shumë kanë humbur në formimin e tyre inepektual, profesional dhe politik. Ata, duke mos e njohur këtë pasuri, s'kanë si ta dinë se duke studiuar e zbërthyer veprën e Isuf Luzit do të jenë në gjendje të shohin se ku çalojnë

programet, apo strategjitë që vënë në jetë ato dhe se çfarë duhet të korregjojnë në keqzbatimin e tyre që kombi të eci drejt zhvillimit. Veprat e këtij Mësuesi të Madh, ku shpaloset përvoja botërore që nga antikiteti dhe deri në pragshekullin e XXI, do të shërbenin si udhërrëfyese, jo vetëm për politikanët, por për mbarë shqiptarët pa moshë, pa bindje, madje dhe pa shkallë kulture. Ai që kërkon të mirën e kombit, e kupton dhe i zbaton edhe në vetvete, për sa ia lejon koha dhe mudësitë e venies në jetë idetë e Isuf Luzit. Veprat e tij nëse futen në programet shkollore, do të ndikojnë pozitivisht te rinia e brishtë studentore, që ende politikat po vazhdojnë ta helmojnë me ideologjitë e tyre duke i kthyer në shabllonist të liderve dhe ambicjeve të tyre. Kjo shembëlltë e politikës te rinia s'është gjë tjetër veçse shkolla e futjes në gjak të vesit, etjes për pushtet, rritjes së interesit të ngushtë personal ndaj politikës, duke i shndërruar të rinjtë në njerëz të ndërruar për një vend pune. Duke i futur rinisë në gjak militantizmin e sëmurë, politika vret lirinë vetjake, dhe nuk i lejon të rinjtë që të formohen si njerëz, si personalitete dhe si individualitete. Si pasojë rinia nuk është në gjendje që të zgjedhë rrugën që duhet të përshkojë, si dhe është e paafte të zgjidhë problemet që i nxjerr koha, pasi i mungon pavarësia e mendimit dhe e vetveprimit. Mohimi i kësaj të drejte njerëzore që është në vartësi të ndërgjegjjes së kujtdo, ua transformon të rinjve karakterin, pasi ata nuk përdorin as logjikën dhe as arsien, ndaj nuk janë në gjendje të pyesin Neveten: "pse që në bangat e gjimnazit duhet të aderojnë në këtë apo në atë forcë politike?!" Me këtë Rini Pluraliste të përçarë, nuk e kuptoj se si do të jetë e nesërmja e kombit, sepse



është vënë në pikëpyetje të madhe ndërgjegjja kombëtare. Si do të mund ta ndërtojnë së bashku demokracinë vallë?! Si në diktaturë edhe tani, të dy grupimet e shohin vëngër njëri-tjetrin dhe më e keqja janë të përçarë. Me të drejtë pyes: "a mund të ecin së bashku në të njëjtat shina të jetës me këtë urrejtjeklasor dhe patologjik, me këtë mlllef ideor dhe me shpresën e lëmshës nga politika?!" Kjo është taktikë e gabuar që e zvodh, e zvetënon, e mpak si ndërgjegjjen individuale, ashtu, edhe ndërgjegjjen e shoqërisë dhe atë kombëtare. Kjo rrugë patjetërsisht e verbër, ajo e tërheqjes së individit nga "X" "Y" forcë politike, a nuk është një lloj persekucioni moral Mbarëkombëtar, që ushtrohet nga politika?! Është mëkati më i madh që vret rininë moralisht e ndërgjegjësisht. Rinia ka nevojë për depolitizim. Kur të shohë se programi i cilës parti i shërben më shumë zhvillimit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar, atëherë le të vendos. Ai program do t'i shërbejë atij dhe shqiptarëve për mirëqenie sociale, që

duhet të jetë synimi thelbësor i politikës. Por a ekziston një program që i siguron jetën lumtur fëmijës dhe moshës së tretë që janë shtresat më në nevojë? Më thoni ju, se cili nga këto programe plotëson kërkesat e dy ekstremeve të shoqësisë sonë?!

Politika nuk përfaqësohet vetëm nga ideat, as nuk qëndron pezull në ajër, ajo frymon, ka programe, statute dhe strategji të zbatueshme nga njerëzit dhe u shërben besnikërisht forcave të caktuara politike. Përsëri jam e bindur se kur të kujtohen institucionet e larta të Kulturës dhe njerëzit e karrigeve të veshura me pushtet, se drejt çfarë literature pedagogjike, filozofike apo juridike duhet të orientohet arsimi, do të jetë vonë.

Dje ka ndodhur një e keqe e madhe. Zjarri në Bibliotekën kombëtare çuditërisht dogji veprat e botuara pas 90-ës. Ndoshta shoqëria shqiptare nuk ka nevojë për një letërsi apo studime të reja bashkëkohore. Mjafton të ngelet gjallë letërsia e Realizmit Socialist.

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT



HILAL FOOD CENTRE

International Food Centre

318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059

VEAL
SPECIAL
OFFER

